

BASHKIA POGRADEC

NR 691/4 RGT

DAT 16.03.2023



16.03.2023
Drejtori
ASHK

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN

Nr. 260/5 Prot.

Tiranë, më 15.03.2023

Lënda: Njoftim për shpronësim publik

**Z. VASKË NIKOLLA GUSHO, ZNJ. IVANA PANDI KALLANXHI,
ZNJ. VENERA PANDI GUSHO, Z. JONI RISTO GUSHO, ZNJ. ELONA NAUM
GUSHO, ZNJ. MARJANTHI LONI GUSHO,
ZNJ. ROKSANELA NAUM PELIVANI, ZNJ. VITIOLA NAUM GUSHO**

Drejtuar: **BASHKISË POGRADEC**

Adresa: *Bulevardi Rreshit Collaku, Pogradec.*

Në zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", i ndryshuar, si dhe të pikës 3, të VKM nr. 126, datë 23.03.2000 "Për përbërjen dhe procedurat e punës së Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit", Ju njoftojmë se:

- Bashkia Pogradec me shkresën nr. 5103/2 prot., datë 24.11.2022, protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin me nr. 842 prot., datë 30.11.2022, ka kërkuar shpronësimin e pasurive të cilat preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i lagjes 'Gani Homçani'".
- Ju do të shpronësoheni për pasurinë e paluajtshme, pronë private* numër 8/161, lloji "Tokë Truall", ZK. nr. 8582;
- Vlerësimi i pasurisë së llojit "truall" është llogaritur bazuar në VKM nr.89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", si më poshtë vijon:

Sipërfaqja totale që shpronësohet është $150.5 \text{ m}^2 \times 10\,491 \text{ lekë/m}^2 = 1\,578\,895.50 \text{ lekë}$;

Vlera totale paraprake e shpronësimit është = 1 578 895.50 lekë

Sipas pjesëve takuese të dokumentuara në kartelën e pasurisë, të konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Pogradec, si bashkëpronarë të pasurisë së paluajtshme nr. 8/161, do të shpronësoheni sipas pjesëve takuese të përcaktuara në kartelën e pasurisë, si më poshtë vijon:

- Z. Vaskë Nikolla Gusho, me pjesë takuese 100/396, me sipërfaqe totale që shpronësohet $38.00505 \text{ m}^2 \times 10\,491 \text{ lekë/m}^2 = 398\,710.98 \text{ lekë}$;
- Znj. Ivana Pandi Kallanxhi, me pjesë takuese 16/396, me sipërfaqe totale që shpronësohet $6.080808 \text{ m}^2 \times 10\,491 \text{ lekë/m}^2 = 63\,793.76 \text{ lekë}$;
- Znj. Venera Pandi Gusho, me pjesë takuese 16/396, me sipërfaqe totale që shpronësohet $6.080808 \text{ m}^2 \times 10\,491 \text{ lekë/m}^2 = 63\,793.76 \text{ lekë}$;

4. Z. Joni Risto Gusho, me pjesë takuese 132/396, me sipërfaqe totale që shpronësohet $50.16667 \text{ m}^2 \times 10\,491 \text{ lekë/m}^2 = 526\,298.50 \text{ lekë}$;
5. Znj. Elona Naum Gusho, me pjesë takuese 12/396, me sipërfaqe totale që shpronësohet $4.560606 \text{ m}^2 \times 10\,491 \text{ lekë/m}^2 = 47\,845.32 \text{ lekë}$;
6. Znj. Marjanthi Loni Gusho, me pjesë takuese 96/396, me sipërfaqe totale që shpronësohet $36.48485 \text{ m}^2 \times 10\,491 \text{ lekë/m}^2 = 382\,762.55 \text{ lekë}$;
7. Znj. Roksanela Naum Pelivani, me pjesë takuese 12/396, me sipërfaqe totale që shpronësohet $4.560606 \text{ m}^2 \times 10\,491 \text{ lekë/m}^2 = 47\,845.32 \text{ lekë}$;
8. Znj. Vitiola Naum Gusho, me pjesë takuese 12/396, me sipërfaqe totale që shpronësohet $4.560606 \text{ m}^2 \times 10\,491 \text{ lekë/m}^2 = 47\,845.32 \text{ lekë}$.

Referuar pikës 2, të nenit 15, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", i ndryshuar, keni të drejtë që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e publikimit të kërkesës në Fletoren Zyrtare, të paraqitni pretendimet Tuaja nëse keni, pranë Bashkisë Pogradec, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e Bashkisë, marrjen e masave për njoftim.

Drejtor i Përgjithshëm
Kryetar
i Komisionit të Posaçëm të Shpronësimeve

Egra Ibrahim



KËRKESË

Nr. 260/4, datë 10.3.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i lagjes ‘Gani Homçani’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Pogradec.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “truall”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1 578 895.5 (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë pesë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR

I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim

